



UNIVERSITETI I GJAKOVËS
"FEHMI AGANI"
UNIVERSITY OF GJAKOVA

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof.Asoc.Dr. Mazllom Kumnova

Nr.prot.: 05/1635
Datë: 23/11/2020

Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", bazuar në nenin 17, paragrafi 6, të Statutit të Përkohshëm të Universitetit, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja për themelimin e Komisionit Këshillëdhënës për çështje statutare dhe mbikëqyrjen e zbatimit të rregulloreve dhe akteve tjera të nxjerra nga organet e Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani".
- II. Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit në Këshillin Drejtues të Universitetit të Gjakovës, përkatësisht nga data 23.11.2020.

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh rolin e Komisionit Këshillëdhënës për çështje statutare dhe mbikëqyrjen e zbatimit të rregulloreve dhe akteve tjera në kuadër të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", me qëllim që ky Komision të informojë autoritetet e Universitetit lidhur me të gjitha rastet e moszbatimit të Statutit dhe akteve tjera në çështjet e caktuara nga autoritetet kompetente, si dhe të merr pjesë në hartimin ose të jap mendimin në procedurën e përgatitjes së akteve dhe Rregulloreve të Universitetit, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 23.11.2020, mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim i dorëzohet:

- 1.Këshillit Drejtues
- 2.Menaxhmentit të UGJFA-së
- 3.Sekretarit të Përgjithshëm
- 4.Njësive Akademike
- 5.Arkivit të UGJFA-së

Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof.Asoc.Dr. Mazllom Kumnova

